

0804-43

3

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

1/14
Pll. Ep.

AKTIVITETE PROJEKTUESE
në arsimin e mesëm të reformuar-gjimnaz



Aktivitete projektuese nga
ARTI FIGURATIV

Përgatiti:
Petre Nanevski

Shkup, 2004

Nevoja e jetës bashkëkohore imponon arsimim më cilësor me horizonte më të gjërë të njohurive dhe aftësive që duhet t'i nxënë apo arrijnë nxënësit. Mësimi i rregullt në arsimin e mesëm-gjimnaz me Planprogramet mësimore nuk i zbrazin (mbarojnë) mundësitë për edukimin dhe trajnimin e të rinjëve, por janë të domosdoshme dhe ka rrugë tjera të ndryshme që i ofronë puna jashtëmësimore dhe jashtëshkollore. Midis formave alternative të arsimimit dhe zgjerimit të kulturës janë edhe asociacionet e ndryshme joqeveritare dhe shoqata profesionale me Programet dhe Projektet e tyre, institucionet profesionale dhe mediat me teknologjinë bashkëkohore: TV, teknika - kompjuterike, internet etj.

Nevoja për inkuadrim të më suksesshëm të të riut në shoqëri dhe në proceset ekonomike, imponon paralelisht me mësimin e rregullt dhe format tjera të arsimimit, të zhvillohen edhe vetitë karakteristike të nxënësit. Ato janë individualiteti i tij, inicijativa, aftësia për organizim të punës, aftësia për dhënie e visionit të detyrës të cilën duhet realizuar dhe disiplina e në realizimin e tij, mendimi fleksibil në kërkimin e zgjidhjeve cilësore, angazhimi i individit nga motivimi deri te punët e kryera të detyrës projektuese. Në procesin edukimit dhe arsimimit, është me rëndësi edhe bashkëpunimi me persona tjerë profesional dhe kolegë nga shkolla dhe jashtë shkollës, shfrytëzimi i kapaciteteve të ndryshme në institucione (disejne, byro projektuese, reparte prodhimi, atelie të artistëve etj. Aktivitetet projektuese si lloj specifik i aktiviteteve edukative kërkojnë që arsimtari në punën e mentorit të gjejë zgjidhje të reja dhe të llojllojshme metodologjike për arritjen e qëllimeve. Ai duhet të tregojë shkathtësi për organizim të shumëllojshëm të punës, krijimi i besimit më të madh dhe më shumë liri, bashkëpunim joformal me nxënësit, prindërit dhe persona tjerë, komunikim fleksibil etj.

2. QËLLIMET

2.1. Qëllimet e përgjithshme

- Vendosja e nxënësve në proceset e ngjarjeve të llojeve të veprave artistike;
- zhvillimi i karakteristikave individuale të nxënësit, iniciativës në dhënie e visionit për realizimin artistik, organizimi i punës, komunikimit, zgjidhja e punëve të përditshme edhe në krijimtarinë artistike;
- nxitja e nxënësit për vërejtjen e vlerave artistike në mjedisin, dhe selektimi i sensacioneve vizuale dhe transformimi i tyre artistik;
- zotërimi i procedurave të reja teknologjike në përdorimin e teknikave dhe materialeve artistike, formati- madhësia e themelit-bazës etj;
- aftësimi i nxënësve për punë individuale hulumtuese në shfrytëzimin e elementeve nga gjuha artistike, materiale dhe teknika artistike edhe në lëmitë e teorisë artistike (estetika, historia e artit, kritika artistike);
- formimi i shprehisë për punë ekipe me nxënës tjerë dhe zhvillimi i ndjenjës për përgjegjësi në kryerjen e detyrave;
- prezentimi i krijimeve të tyre artistike në ekspozitë shkollore ose në ndonjë ekspozitë tjetër rinore.

2.2. Qëllimet konkrete

- Aftësimi i nxënësit për zgjedhjen e temës dhe motivit të detyrës projektuese dhe krijimi i visionit dhe realizimi i final .
- nxitja e interesit për krijimtari artistike dhe realizimi kreativ i parafytirimit artistik në material , në lëmi të ndryshme artistike dhe teknika;
- krijimi i interesit dhe shprehisë për vizitë të ekspozitave dhe manifestimeve tjera artistike dhe zgjerimi i kulturës artistike;
- hulumtim në zbatimin e gjuhës artistike, materialet dhe teknikat artistike, gjetje e shprehjes (stilit) individual artistik;
- krijim individual i veprës (projekt) artistike të formatit standard ose të madh dhe pjesëmarrja në përpilimin e ekipor për veprë të dimensioneve të ndryshme (për rregullim estetik të enterierit ose eksterierit të shkollës) etj;
- krijimi i shprehisë të rezultatit analitik për organizimin dhe realizimin e detyrës projektuese (përpunimi në formë të shkruar të konceptit ideor, skicë, studio, konstruksion financiar etj)
- aftësim për valorizim estetik të rezultateve dhe guximi për paraqitje (prezentim) (organizimi i ekspozitës) dhe arsyetimi teorik i veprës;
- Nxiije e iniciativës individuale për organizimin dhe realizimin e detyrës projektuese dhe bashkëpunimi me persona profesional dhe institucione përkatëse për realizimin e qëllimit;
- prezentimi i realizimeve figurative, realizimi i ekspozitave individuale ose grupore në shkollë edhe për opinionin më të gjërë në galeri dhe në vende tjera;
- botimi i punimeve të tyre të shkruara (kritikë figurative, eseje, parathënie për katalogun etj) , në revista shkollore, gazeta për të rinjë, katalogë figurativ etj;

3. DREJTIME TË PËRGJITHSHME PËR PLANIFIKIMIN E AKTIVITETEVE

- fondi vjetor i orëve me vëllim nga 35 orë (edhe më shumë nëse nxënësi tregon interesim)
- a) 15 orë , të cilat arsimtari i shfrytëzon për dhënien e drejtimeve të përgjithshme për zgjedhje të medias (lëmi figurative, teknika, drejtim etj) sqarime për metodologjinë e punës, organizimin e zbatimit të parafytiruar, kryerje e korrekturës gjatë procesit krijues dhe drejtime për prezentim dhe arsyetim (vështrim teorik i detyrës projektuese të relizuar).
- b) 20 orë (mund edhe më shumë orë pavarësisht nga interesi i nxënësit dhe vëllimit të detyrës projektuese), të cilat nxënësit i shfrytëtojnë për përpunimin e detyrës projektuese dhe prezentimit të paraqitjes së projektit. Veçanërisht në këtë pjesë të punës do të vijë në shprehje angazhimi individual i nxënësit dhe liria e të krijuarit mundësitë për bashkëpunim jashta shkollës.
- realizimi në vitet mësimore -prej v. I deri v.IV
- realizimi sipas shprehjes së lirë të nxënësit në shkollë dhe jashta saj (byro të disejnuara, reparte prodhuese të organizatave punuese, atelje të artistëve, shitore zejtarësh etj).

4. ORIENTIMI I AKTIVITETEVE PROJEKTUESE NË ARTIN FIGURATIV

* Tendencën globale e aktiviteteve projektuese në artin figurativ është nxitja e iniciativës dhe krijimit figurativ të pavarur (teorike ose praktike dhe zhvillim i aftësisë kreative të nxënësit. Në këtë drejtim është edhe zgjerimi i kulturës së përgjithshme dhe asaj figurative përmes shfrytëzimit të resurseve shkollore dhe të

jashtme (persona profesional, institucione, shoqata, muze^{me}, byro disejnuese, kapacitete prodhuese të ndërmarjeve). Një pjesë nga produksioni figurativ i nxënësve do të dedikohet për formësimin e ambientit estetik të enterierit dhe eksterierit të shkollës. Pastaj aktivitetet për bashkëpunim me seksionet tjera dhe lëndët tjera mësimore në pasurimin e jetës kulturore të shkollës (regullimi figurativ i skenës dhe kostumografisë për shfaqje të caktuara për patriotat ose rast tjetër, disejnim i gazetës shkollore etj).

* Realizimi i aktiviteteve projektuese do të zbatohet me organizimin e punës në faza të ndara duke i respektuar ligjet e procesit të vendosjes së veprës figurative:

- ballafaqimi i problemeve figurative dhe vlerësimi kritik i informatave;
- inkubacioni, lirimi, të fantazuarit, mendimdivergjent, lojë.
- lojë kreative (iluminacion), (përpunimi i skicave, kombinime, hulumtim, definimi i idesë figurative).
- realizimi në material i idesë figurative.
- verifikim- vlerësim i rezultatit të arritur.

Procesi i realizimit të aktivitetit projektues përmban zbulim të idesë figurative, planifikim të punës, organizim dhe realizim të parafytyruar me ç'rast shfrytëzohen njohuritë e reja për artet figurative dhe shfrytëzimi i teknologjisë bashkëkohore- interneti në grumbullimin e të dhënave dhe kompjuter në përpunimin e skicave ose zgjidhjeve ideore për disejnim grafik.

* Mundësitë për realizimin e detyrave projektuese janë të llojllojshme, por është e preferueshme të jenë të drejtuara drejtë demonstrimit parafytyruar në mënyrë të vendosjes teorike në formë të shkruar (hipotezë, përkatësisht elaborim i idesë - parafytyrimi figurativ atëher kur bëhet fjalë për punën figurative-krijuese), zgjedhja e materialeve, lokalit, specifikave të shpenzimeve etj. Pastaj puna duhet të përfshijë punë hulumtuese, vëzhgim, grumbullim të informatave dhe dhënie e vërejtjeve- përpunimi në skica, bashkëpunimi me anëtarë tjerë të grupit, kur bëhet fjalë në grupe etj.

* Në aktivitetet projektuese duhet të dominojë puna e pavarur krijuese e nxënësve në lëminë e teorisë figurative ose praktikës figurative. Në këtë lëmi do të mundësohet inicijativa e tërësishme dhe liria e zgjedhjes së temës, media (lëmia dhe teknika figurative) dhe angazhimi i tërësishëm i potencialit të nxënësve dhe qëllimi i veprave të realizuara dhe bashkëpunimi me persona profesional dhe subjekte tjera.

5. LËMITË E AKTIVITETEVE PROJEKTUESE

Aktivitetet projektuese do të zhvillohen në dy lëmi nga kultura dhe krijimtarija: teoria figurative dhe praktika figurative.

3.1. Aktivitetet projektuese nga lëmi i teorisë praktike:

- historia e artit;
- kritika figurative*,
- estetika*,
- gjuha figurative - elemente dhe parime

3.2. Aktivitetet projektuese nga lëmi i praktikës figurative (realizimi i veprave figurative në material, në lëmi dhe teknika të caktuara figurative):

- vizatim
- fotografim
- skulpturë
- grafikë
- disejn (arti i aplikuar) dhe komunikime vizuele
- arkitekturë

6. TEMA PËR AKTIVITETET PROJEKTUESE

Pavarësisht nga materialet dhe kushtet materialo-teknike në shkollë dhe jashtë saj, nxënësit detyrat projektuese i zgjedhin, përkatësisht propozojnë tema nga këto lëmi teoria figurative dhe praktika figurative.

Lista e ofruar e temave ka qëllim të orientuar kurse arsimtarët mund ta ndryshojnë, plotësojnë dhe të vendosin përmbajtje, të cilat nxënësit vetë do ti zgjedhin dhe propozojnë në bazë të interesit, dëshirës, senzibilitetit të tyre dhe motivimeve tjera.

Teoria figurative

Tema nga historia e artit:

- Hulumtimi dhe përpunimi i stilit figurativ të caktuar nga historia (proceset shoqërore, ekonomike, kulturore etj. për vendosjen e stilit të artit figurativ dhe më gjërësisht në art; - Përpunimi i drejtimin të caktuar figurativ në zhvillimin e artit figurativ (proceset shoqërore, ekonomike, kulturore etj);
- Shqyrtim i opusit figurativ të një artisti figurativ (jeta dhe vepra),
- Analiza e vlerave estetike e një vepre të caktuar figurative (koha e ngjarjes, proceset shoqërore, ekonomike, kulturore etj), për ngjarjet, ndikimi i veprës për përcaktim të mëtutjeshëm të vetë autorit etj.
- Komparacioni i stileve të caktuara artistike, stileve, drejtimeve; artistëve figurativ; veprave etj.
- Hulumtimi për zhvillimin e arkitekturës në periudha të ndryshme dhe vende gjeografike (stile, objekte të realizuara, autorë etj.).

Tema nga kritika figurative

- Vizitë në ekspozitë figurative dhe të shkruarit vështrim kritik individual për ekspozitën ose në veçanti për vepër të caktuar figurative (ose vepra);
- Analizë për karakteristikat e krijimtarisë artistike të gjeneratës së caktuar të krijuesve figurativ (sipas supozimit të veprave figurative në muzej ose sipas kritikave paraprake figurative dhe esej nga ish kritikë figurativ dhe teoricientë.);
- Vështrim kritik në kahjes së caktuar figurative, grup krijuesish (futuristë, nadrealistë etj) krijues, vepër figurative etj.
- Kritikë artistike në ekspozitën e nxënësve (në shkollë, ekspozitë vjetore të nxënësve në arsimin e mesëm etj);
- Esey për karakteristikat e artit figurativ bashkëkohor (në Botë, Maqedoni, për grup artistësh, individë, lëmi figurative (vizatim, fotografim, grafikë, skulpturë, disejn, arkitekturë), disiplina të artit figurativ etj.

Tema nga estetika:

- Vështrim (analizë) të koncepteve estetike të artit - kulturës së popujve antik dhe civilizimeve të tyre , krijimi i rregullave (kanone), egjiptase, greke, rome, bizantine etj;

-Karakteristika për kuptimin e estetikës antike: Platoni; Aristoteli; etj.; renesansa: Fibonaçi, Leonardo dhe mendimtarë dhe estetikë më bashkëkohorë: Kanti, Hegeli, Kroçe, Arnold, Hauzer etj;

Tendenca në estetikën bashkëkohore

- Vështrim i estetikës në ekspozitë të caktuar të "DLUM", grupë autorësh, krijues të artit figurativ, lidhshmëri me llojet tjera të artit (muzikë, teatër, literaturë, film etj)

Tema nga gjuha artistike figurative - elementet dhe parimet:

- Analiza e zhvillimit të gjuhës figurative nga antika deri më sot dhe karakteristikat në periudha të caktuara;

- Elementet dhe parimet figurative në vizatim; fotografim; skulpturë; grafikë;disejn; arkitekturë; dhe specifikat e shprehjes figurative;

- Analiza e zbatimit të elementeve dominuese nga vendi dhe parimet në stil të caktuar artistik; drejtim; grup autorësh, krijues, vepër e artit figurativ etj;

- vështrim i zbatimit të disa elementeve figurative në lëmi të ndryshme figurative-karakteristike (dallimet dhe ngjajshmëritë).

Dominimi i disa elementeve figurative në art,nga vendi ose lëmi gjeografike (psh. linja dhe vëllimi në artin japonez etj)

Praktika figurative

Nxënësit sipas interesit dhe afinitetit individual mund të zgjedhin përmbajtje për krijim individual figurativ nga medi të ndryshme figurative dhe të marrin pjesë në grupe (në lloje të seksioneve dhe klubeve: fotografim , grafikë; skulpturë etj) në këto lëmi vijuese:

Vizatim:

- Përpunimi i fotografive , skicë si përgatitje për përpunimin e disa ideve figurative;

- Përpunimi i vizatimit (seritë e vizatimit) të caktuara (ose të ndryshme) në teknika dhe materiale figurative, motiv , themel apo bazë,sipërfaqja dhe zbatimi i elementit të caktuar figurativ (me qëllim që të hulumtohen mundësitë shprehëse të materialit dhe teknikës figurative, zbatimi i elementit figurativ etj);

- Përpunimi i studios në motiv të caktuar (portret, figurë, pejsazh, natyrë e vdekur etj);

- Përpunimi i "kartonit-kartelës" - vizatim në madhësi 1:1 si përgatitje për realizimin e veprës tjetër figurative (fotografi, relief, freskë, mozaiku etj)

- Përpunimi i vizatimit me karakteristika individuale kreative.

- Zbatimi i gradacionit tonik në vizatim;

- Shfrytëzimi i i elementit të caktuar figurativ në varijante të ndryshme në seritë e të vizatuarit.

- Zgjedhja dhe zbatimi i elementeve dhe parimeve të ndryshme në të vizatuarit.

Fotografimi:

- Përpunimi i skicave në variante ngjyrash për përpunimin e idesë së caktuar figurative;

- Përpunimi i krijimit figurativ në teknikë, motiv dhe format të caktuar figurativ;

- Hulumtimi i zbatimit të llojeve të ndryshme të teknikave dhe materialeve në fotografim në motiv të njejtë (të ndryshëm) dhe në varijante të ndryshme; Studimi i motiveve të caktuara me zbatimin e ngjyrave lokale, e më pas i njejtë kompozicion të fotografohet me ngjyra abstrakte;
- Shfrytëzimi i ngjyrave akromatike në të shprehurit figurativ;
- Zbatimi i ngjyrave elementare, sekundare, komplementare, të dhesta, ngjyra në fotografim të motivit të caktuar;
- Shfrytëzimi i shkallëzimit tonik dhe kontrasteve të dhesta -të ftohta për shprehje të vendit-lokalitetit.

Skulptura:

- Përpunimi i skicave në vizatim ose argjil (glinë) për realizimin e skulpturës në format më të madh;
- realizimi i skulpturës sipas parafytirimit të lirë në material të caktuar: argjil (glinë), stiropor, dru, gurë, metal etj.
- Përpunimi i studimit me glinë në portret; figurë; kompozicion me dy ose me shumë figura;
- Modelimi i relievit (i cekët, i lartë, negativ);
- Konstituimi i skulpturës prej materialeve të ndryshme - asambleshë;
- Realizimi i skulpturës në (glinë dhe pjekje);
- Ngjyrosja e skulpturës për dedikim të caktuar.

Grafika:

- Përpunimi i skicave (bardhë-zi dhe me ngjyra) për zgjidhje grafike;
- Hulumtimi i zbatimit të monotipisë, grotazh (bardhë-zi dhe me ngjyra);
- realizimi i grafikës në teknika të ndryshme: linorez, drurez, litografi; gjëlpërë e thatë (me shfrytëzimin e kapaciteteve jashtë shkollës dhe bashkëpunim me artist të caktuar ;
- Shfrytëzimi i teksturës në grafikën me bardhë e zi , përkatësisht ose me ngjyra;
- Përpunimi i grafikës në ngjyra;

Disejni:

- Përpunimi i skicave për disejn të tekstilit për qëllime të ndryshme (rroba, amvisëri etj)
- realizimi i planit të rrobave (komplete ose pjesë) për sezonë ose nevojë të caktuar (solemne, pune, sportive) ose për moshë të caktuar (për fëmijë, të rritur, ose individ në moshë, garderobë meshkujsh, femrash etj) edhe sipas mundësisë të realizimit të idesë në material;
- Përpunimi i planeve për kostume të shkollave, tetrove, ose shfaqjeve muzikore;
- Përpunimi i zgjidhjeve figurative për disejn grafik: mbishkrim për manifestim shkollor, ilustrime (për gazetën e shkollës), kopertina të librave, logove etj;
- Përpunimi i planeve për disejn industrial (skica, vizatime, zgjidhje tredimensionale) për automjete, telefona celular etj;
- Realizimi në material të zgjidhjes ideore- disejn në bashkëpunim me institucion të caktuar ose organizatë punuese të caktuar;

Arkitektura:

- Përpunimi në skica- vizatime për objekte të caktuara arkitektonike (klube rinore, fushësportive për fëmijë);
- Përpunimi i vizatimit elementar për objekt arkitektonik të caktuar;
- Realizimi i maketës-modelit për objekt të caktuar (vilë në mal etj)

- Përpunimi i shfaqjes të elementeve kryesore të zgjidhjes urbanistike në një lokal të caktuar etj.

Grupe krijuesish figurativ të formatit të madh:

- Vëzhgim të lokalit shkollor (entierit dhe eksterierit) dhe emërimi apo shënimi i ideve (ide të bujshme) për formësim estetik të lokalit, koridorit të caktuar , përkatësisht shkollën në tërësi;
- Përgatitje e elaboratit për rregullim estetik të shkollës me propozime konkrete dhe arsyetuarit e tyre;
- Përpunimi i krijimit grupor figurativ (vizatim, fotografi, skulpturë, grafikë) për rregullim estetik në pjesën e enterierit ose eksterierit të shkollës;
- Formësimi i zgjidhjeve ideore dhe realizimi në pano për ekspozite me lëndë tjetër mësimore (histori, biologji etj);
- Përpunimi i projektit për realizime bashkëkohore figurative: intervenim në lokalim; aksion; hepening etj;
- Organizimi i ekspozitës figurative (ekspozitë individuale e nxënësve në paralele, klasë-vit etj);

Për realizimin e detyrave individuale projektuese të praktikës të artit figurativ do të duhej që të përpunohet edhe tekst (elaborim i shkurtër teorik) për parafytirimin figurativ, organizimi i punës: kushte lokale; specifikat e materialeve të nevojshme, konstruksion financiar, etapat e realizimit etj.

Realizimi i detyrës projektuese mund të realizohet me lidhshmërinë apo bashkimin e më së paku dy orëve , përkatësisht në katër orë që do të realizohet në një ditë të muajit (të shtunën ose ditë tjetër gjatë muajit)

7. ORGANIZIMI DHE REALIZIMI

Organizimi i aktiviteteve projektuese mund të realizohet në lloje të klubeve, seksioneve ose grupe (klub fotografist, grafikë për disejn etj). Nxënësit gjatë zgjedhjes së grupit (klubit-seksionit) ku do të marrin pjesë , përkatësisht me cilën lëmi figurative do të merren, është e preferueshme që të merren me atë medium një periudhë më të gjatë (psh. një gjysmëvjetor) me qëllim që t'i qasen asaj problematike (fotografimit ose skulpturës). Gjithsesë nxënësi mund të krijojë në një medium të caktuar në periudhë edhe më të gjatë (disa vite në vijim) , por mentori mirë është që ta drejtojë nxënësin që përkohësisht të hulumtojë -eksperimentojë edhe në lëmi tjetër (lëmi figurative, teknikë, materiale etj ose në lëmin e teorisë së artit).

Edhe pse në punën figurative-krijuese mbizotëron forma individuale e punës , mund të shfrytëzohen mënyra të ndryshme organizative: paralelisht nxënësit mund të realizojnë çdo aktivitet të tyre projektues në kohën e njejtë në shkollë dhe jashta saj, kurse arsimtari të bëjë korrekturën dhe punën këshillëdhënëse. Gjithashtu, arsimtari në mënyrë individuale mund të punojë me secilin nxënës në kohë të ndryshme dhe jashta shkollës në atelje të ndonjë shkenctari, byro projektuese për disejn, organizatë punuese etj. Në këtë rast nxënësi do të punojë pavarësisht, kurse arsimtari ndërkohë do ta udhëzojë në tendencat e përgjithshme dhe parafytirimin e nxënësit. Për rregullimin estetik të enterierit dhe eksterierit të shkollës, shpeshherë, për arsye të vëllimit të dimensioneve do të duhej të zbatohet vepra figurative në vendin e caktuar psh në koridor, në muret e koridorit ose në sipërfaqet e qelqta të shkollës, ose në lokal të

hapur në oborrin e shkollës. Për këtë lloj të intervenimeve figurative nevojitet organizim dhe përgatitje e veçantë si për shembull përpunimi i konstruksionit të veçantë të siguruar - vend (skele) për punë të plesëve më të larta të murit, specifikimi dhe furnizimi i materialeve etj. Për organizim solid të punës është e domosdoshme që me kohë të sigurohet materiali figurativ, mjetet , veglat dhe mjetet ndihmëse me çrast paraprakisht bëhet specifikimi adekuat dhe konstruksioni financiar në kuadër të konceptit për aktivitetin projektues.

Në organizimin e punës bie edhe bashkëpunimi me institucione tjera nga kultura, organizata joqeveritare, shoqata dhe individë për realizimin e ndonjë Projekti ose organizim dhe realizimin e manifestimeve të përbashkëta me nxënësit dhe arsimtarët e lëndëve tjera mësimore etj.

Obligimet e arsimtarëve

- Angazhim më i madh si arsimtarë - mentor, për shkak të statutit të pavoritshëm të lëndës në sistemin arsimor;
- planifikimi i aktiviteteve aftgjate (prej disa viteve p.sh. për rregullim estetik të enterierit dhe eksterierit të shkollës) dhe periudhë afatshkurtër (për një vit shkollor);
- formimi i grupeve pavarësisht nga kushtet në shkollë (lokale, materiale-teknike dhe kohore etj) sipas mundësive të caktuara:
 - a. grupet mund të formohen sipas moshës të nxënësve (viti-klasa);
 - b. sipas interesimit të profesionit me lëmi të caktuar figurative në lloje të klubeve grupe: klub i fotografisë, grafik, për dizajn, të teorisë figurative artistike, historisë së artit-kritikë figurative etj;
- caktimi i kohës - ditët dhe orët atëherë kur do të paraqiten aktivitetet në shkollë me tendencë që këto aktivitete që të mos ta pengojnë paraqitjen e mësimit të rregullt;
- vendosja e nxënësve në problematikën e përgjithshme të aktiviteteve projektuese dhe ruajtja e karakteristikave dhe mundësitë për zgjedhjen e temës nga teoria dhe praktika artistike figurative (lëmi a artit figurativ);
- konkretizimi i detyrave, afatet dhe mundësitë për bashkëpunim dhe zgjedhja (propozim) nga nxënësit për detyrë të caktuar projektuese;
- ndihmë instruktive nxënësit (grupit) për kryerjen e detyrës;
- kryerja e korrekturës dhe punë tjetër këshilldhënëse gjatë formësimit të idesë krijuese të nxënësve;
- regjistrimi i aktiviteteve dhe evidenca e punës të çdo nxënësi dhe përfundimi i detyrës në portfolio.

Obligimet e nxënësve

- Zgjedhja e aktivitetit projektues të caktuar, medium dhe procedurë e punës të çdo nxënësi sipas intereseve individuale;
- angazhim dhe formësimi i detyrës projektuese në një periudhë të caktuar kohore;
- bashkëpunim me nxënë, arsimtarë dhe prindër tjerë, në realizimin e detyrës projektuese (vepër figurative) nga formati më i madh për nevojat e shkollës dhe për nevoja tjera (dhuratë personit të caktuar, institucionit etj);
- bashkëpunim permanent i nxënësve (mesveti dhe me arsimtarin etj) për të arritur cilësi më të mirë dhe racionalizëm;
- organizim të pavarur i ekspozitës ose manifestimeve, vështrim teorik kritik (parathënie për katalog etj) në shkollë, galeri figurative ose ngjarje në vend tjetër (TV)

Bashkëpunimi

- Bashkëpunim me nxënësit tjerë të grupit (ekipit), paraleles dhe të tjera në shkollë;
- me arsimtarin e lëndës dhe me arsimtarët tjerë, individë tjerë profesional jashta shkollës;
- me individë të shërbimit pedagogjiko-psikologjik dhe me bashkëpunëtorë të jashtëm;
- me artistë figurativ, kritikë, dhe të tjerë nga lëmi i arsimit dhe kulturës etj;
- bashkëpunim me institucione arsimore, kulturës, organizata joqeveritare, shoqata profesionale etj.

Normativi i kuadrit mësimor:

Aktivitetet projektuese mund t'i kryejë individ me :

1. Studime të kryera nga arti figurativ- dega pedagogjike, VII-1;
2. Studime të kryera nga arti figurativ - degë tjera dhe ka fituar përgatitje pedagogjike, psikologjike dhe metodike në Fakultetin e artit figurativ, VII-1.